



UDHËZUESI

***për shfrytëzues për kalimin nëpër procese afariste
gjatë shfrytëzimit të SIKTK-ës tekstuale***

Versioni i avancuar

Mars 2009



PËRMBLEDHJE

<i>Hyrje dhe pasqyrë e përgjithshme e sistemit</i>	<i>6</i>
Sistemi i informatave të kadastrit të Kosovës	7
1. Pasqyrë e përgjithshme e sistemit	8
2. Pasqyra e përgjithshme e lëndëve	14
3. Skenarët e bazuar në llojet e ndryshme të lëndëve.....	19
<i>MODULI PËR MENAXHIMIN E LËNDËS</i>	<i>22</i>
1. Si me u Kyçë (Log-in) në SITK	23
2. Si me i regjistruar lëndët	25
3. Si me e kërkuar dhe zgjedhur parashtruesin e kërkesës apo personin e autorizuar në faqen “Regjistro lëndën”	35
4. Si me e shtuar personin e ri në faqen “Regjistro lëndën”	39
5. Si me e caktuar lëndën	45
6. Si me filluar përpunimin e lëndës në Faqen për zgjidhjen e lëndës age.....	50
7. Si me e refuzuar/hedhur poshtë lëndën në Faqen për zgjidhjen e lëndës	52
8. Si me e zgjidhë nënndarjen	54
9. Si me i zgjidhur shumë nëndarje	76
10. Si të zgjidhet një bashkim i parcelave	87
11. Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë.....	103
11.1 Si me e zgjidhë Bartjen e pronësisë me blerje.....	109
11.2 Si me e zgjidhur Bartjen e pronësisë sipas trashëgimisë.....	117
11.3 Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë me këmbim	130
11.4 Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë sipas dhurimit/donacionit	142
11.5 Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë me suksesion.....	151
11.6 Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë me eksproprijim.....	158
11.7 Procedura e njoftimit publik	165
11.8 Si me e regjistruar posedimin.....	172
12. Si me e zgjidhë bartjen e pronësisë.....	174
13. Si me e regjistruar hipotekën	176



14.	Si me e regjistruar servitutit	191
15.	Si me e regjistruar vërejtjen.....	208
16.	Si me e regjistruar llojet shumta të të drejtave në pjesën tekstuale të SIKTK-ës.....	214
17.	Si me e regjistruar të drejtën në shumë njësi kadastrale në SIKTK-ën tekstuale	218
18.	Si me i anuluar/çaktivizuar të drejtat në shumë njësi kadastrale	226
19.	Si me i azhurnuar hollësitë kadastrale të objektit kadastral parcelës.....	228
20.	Si me e regjistruar ndërtesën e re në një parcelë ekzistuese	230
21.	Si me e regjistruar ndërtesën e pavarur.....	234
22.	Si me e regjistruar pjesën e re të ndërtesës.....	237
23.	Si me e paraqitur arkivin (historinë) e përpunimit të lëndës	242
24.	Koha e përshkuar e njërive kadastrale	242
25.	Koha e përshkuar e lëndës	247

MODULI I INFORMATAVE..... 250

1.	Faqja e raporteve dhe statistikave në SIKTK.....	251
2.	Lista e “Raporteve dhe statistikave” të cilat do të krijohen nga SITK-ja.....	257
2.1	Numri i fundit kadastral mbi zonën e zgjedhur kadastrale	257
2.2	Statistikat për parcelat Urbane/Rurale	258
2.3	Statistikat mbi Njësitë kadastrale : parcelat /ndërtesat/pjesët e ndërtesave/përçojat	258
2.4	Statistikat mbi numrin e pronarëve në komunë/zonë kadastrale	259
2.5	Raporti statistikorë mbi migrimin	259
2.6	Numri i certifikatave të paraqitura në mënyrë vizuale nga shfrytëzuesi	260
2.7.	Lista e lëndëve të pranuar ose të refuzuara sipas llojeve të lëndëve në një periudhë kohore të caktuar.....	262
2.8.	Të dhënat statistikore të lëndëve të ZKK-ve sipas shfrytëzuesit, llojit të lëndëve dhe statusit për një periudhë kohore	264
2.9.	Hipotekat e regjistruara dhe të lëshuara në periudhën kohore të specifikuar nga shfrytëzuesi	266
2.10.	Sipërfaqet dhe kulturat sipas zonës kadastrale dhe komunës.....	268
3.	Si me KËRKUAR DHE PARAQITUR NJËSINË KADASTRALE në SIKTK-ën tekstuale.....	271
4.	Si me KËRKUAR DHE PARAQITUR PERSONIN NË SIKTK-ën tekstuale	278

MODULI I SHËRBIMEVE..... 281

1.	Si me i lëshuar certifikatat në SIKTK	282
----	---	-----

2.	Ofrimi i shërbimit të të dhënave nga SIKTK-ja.....	296
2.1	Shërbimi i të dhënave i komunës të ofruara Administratës tatimore.....	297
2.2	Shërbimi për të dhënat e komunës të cilat i ofrohen organeve tjera të Kosovës	305
2.3	Shërbimi i të dhënave të zonës kadastrale të ofruara Administratës tatimore.....	306
2.4	Shërbimi i të dhënave të zonës kadastrale të ofruara organeve tjera të Kosovës.....	312
2.5	Shërbimi i të dhënave të njësive të përzgjedhura kadastrale për gjeodet.....	313
2.6	Shërbimi i të dhënave të zonës kadastrale gjeodetëve për rindërtimin e kadastrit.....	322
3.	Importimi i të dhënave në SIKTK	323
3.1	Transformimi i zonës kadastrale duke i zëvendësuar të dhënat ekzistuese me ato të rindërtimit.....	324
3.2	Matjet sporadike.....	325
3.3	Importimi i të dhënave kadastrale nga sistemi i jashtëm	326

MODULI I MENAXHMENTIT..... 327

1.	Si me i krijuar dhe menaxhuar SHFRYTËZUESIT në SIKTK	328
1.1	Shtimi i shfrytëzuesit të ri.....	329
1.2	Si me i menaxhuar të drejtat e qasjes për çdo shfrytëzues	332
2.	Si me i caktuar rolet e shfrytëzuesve	335
2.1	Si me e “resetuar” fjalëkalimin për shfrytëzuesit.....	338
2.2	Si me e çaktivizuar shfrytëzuesin.....	338
2.3	Si me i zhblokuar shfrytëzuesit	339
2.4	Ndërrimi i fjalëkalimit për shfrytëzuesin e regjistruar	341
3.	SI ME I MENAXHUAR FJALORËT NË SIKTK.....	342
4.	SI ME E VENDOSUR NJOFTIMIN PUBLIK NË LLOJIN E LËNDËS NË SIKTK.....	347
	Lista e GJENDJEVE TË LËNDËS	348
5.	Lista e fjalorëve për Hollësitë e CadastralUnit kadastral (tributeve).....	349
6.1	Klasifikimi i fjalorit për PARCELA.....	349
6.2	Klasifikimi i fjalorit për NDËRTESA	355
6.	Lista e mesazheve për gabime dhe vërejtje të SITK-ës.....	359

MIGRIMI NGA RDPP-ja 367

– PROCEDURA –..... 367

1.	Migrimi i të dhënave prej RDPP-ës në SIKTK	368
1.1	Nxjerrja/eksportimi i të dhënave prej RDPP-ës.....	369
1.2	Importimi i të dhënave prej dosjeve CSV në SIKTK.....	373



Hapi 0. Përgatitja e dosjes CSV për migrimin e komunës.....	375
Hapi 1. Regjistrimi i lëndës dedikuar migrimit të një komune.....	375
Hapi 2. Caktimi i lëndës për t'u përpunuar nga shfrytëzuesi	375
Hapi 3. Fillimi i përpunimit të lëndës së migrimit në Zgjidhjen e lëndës.....	376
Hapi 4. Shfletimi dhe përzgjedhja e dosjeve CSV të cilat do të migrohen	377
Hapi 5. Aplikimi i konfirmimeve të vlefshmërisë në Tabelën e përkohshme (konfirmimi i vlefshmërisë 2)	383
Hapi 6. Krijimi i raportit mbi njësitë kadastrale me gabime të cilat nuk do të migrohen	386
Hapi 7. Aktivizimi (përdorimi) i mjetit kryesorë për procedurën e migrimit	391
Hapi 8. Krijimi i “Raportit mbi gabimet e migrimit”, nëse ka ndonjë.....	393
Hapi 9. Korrigjimi i të dhënave të mbetura/shënimeve të pamigruara.....	394



Hyrje dhe pasqyrë e përgjithshme e sistemit



Sistemi i informatave të kadastrit të Kosovës

Sistemi i informatave të kadastrit të Kosovës (SITK) është modeluar për të qenë bazë e për administrimin e tokës në Kosovë. Ai do t'a zëvendësojë Regjistrin ekzistues të të drejtave për pronat e paluajtshme (RDPP), duke ofruar një sistem më të sigurt, më të fuqishëm dhe më efikas dhe me funksion të rritur.

SITK-ja është një sistem dinamik; që donë të thotë që ai është i modeluar për t'u rritur dhe zhvilluar gjatë viteve të ardhshme. Andaj, ky doracak për shfrytëzuesit do të azhurnohet (përditësohet) sipas zhvillimit të mëtejshëm të SITK-ës.

Shpresoj që ky doracak do të mundësojë që kuadrot e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe ata të zyrave komunale kadastrale të kuptojnë dhe shfrytëzojnë SITK-ën për të mirë të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Versioni aktual i doracakut është nxjerrë në mars të vitit 2011 dhe përfshinë versionin e avancuar të udhëzuesit për kalimin nëpër proceset afariste të sistemit SIKTK-ës.

Murat Meha

Kryeshef ekzekutiv

Agjencia Kadastrale e Kosovës

mars 2011

1. Pasqyrë e përgjithshme e sistemit

Aplikacioni i SITK-ës është aplikacion i bazuar në web me bazën qendrore të të dhënave e cila shfrytëzon SQL Serverin për ruajtjen e të dhënave.

Përparësia e aplikacionit të bazuar në web, krahasuar me aplikacionin klasik kompjuterik, qëndron në faktin se nuk ka nevojë të bëhet ndonjë instalim në kompjuterët e shfrytëzuesve, nuk ka probleme me sinkronizimin e versioneve dhe azhurnimin e aplikacionit, të gjithë shfrytëzuesit mund t'i qasen dhe ta shfrytëzojnë versionin e njëjtë të aplikacionit në të njëjtën kohë.

Web faqes mund t'i qasemi përmes linkut apo web adresës përmes çfarëdo web shfletuesi nga çfarëdo lokacioni i cili është pjesë e rrjetit të njëjtë duke shfrytëzuar kërkesa minimale kompjuterike; ku edhe PC-ja e thjeshtë, e cila ka qasje në rrjetë, mund të përdorte si terminal për të operuar dhe për t'ju qasur aplikacionit të SITK-ës.

Aplikacioni i SITK-ës shërben si aplikacion për menaxhimin e kadastrit dhe lëndëve juridike si dhe për menaxhimin e dokumenteve, i cili i ofron klientëve shërbime dhe i cili ruan të dhëna për shfrytëzimin e tokës dhe pronësi në Kosovë. Përparësitë tjera të aplikacionit të SITK-ës janë zhvillimi i moduleve të reja dhe zbatimi i tyre pa shkaktuar ndryshime në modulet funksionale të zbatuara më herët. Shfrytëzuesi dhe puna e tyre nuk do të pengohet dhe ata do të mundën me i shfrytëzuar azhurnimet menjëherë.

Aplikacioni i SITK-ës është i lehtë për shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesve dhe është një aplikacion ndër-aktiv i cili shfrytëzon web formatet ku shfrytëzuesve ju nevojiten shkathtësi kompjuterike dhe përpjekje minimale për t'i plotësuar dhe ruajtur të dhënat gjatë përpunimit të lëndës.

Këtu kërkohet plotësimi i të dhënave minimale, kurse shumica e operacioneve dhe procedurave kryhen duke i zgjedhur të dhënat nga “dropdown” fushat dhe listat dhe duke i aktivizuar apo çaktivizuar katrorët për verifikim në dispozicion, apo duke konfirmuar apo anuluar operacionet dhe duke i ruajtur të dhënat me shtypjen e pullës.

Aplikacioni i SITK-ës do ta zëvendësojë aplikacionin e vjetër të paazhurnuar të RDPP-ës i cili ka qenë i instaluar në kompjuterët e ZKK-ve të cilët i janë qasur dhe i kanë ruajtur të dhënat në serverin qendror të bazës së të dhënave i cili ka qenë e vendosur në AKK.


Nuk kanë ekzistuar çështje të funksionalitetit të cilat do të kishin shpie deri te kërkesa për ndryshimin apo ngritjen e nivelit të aplikacionit dhe krijimin e aplikacionit më të mirë, me ç'rast problemet e shkaktuara nga mospërputhja e versioneve të aplikacioneve të instaluar në ZKK-ët do të zgjidheshin.

Aplikacioni i RDPP-ës e ka mundësinë e nxjerrjes së të dhënave nga baza e vetë e të dhënave dhe të gjitha ato të dhëna janë migruar në aplikacionin e ri të SITK-ës ku ato mund të kontrollohen dhe shfrytëzohen për përpunim të mëtejshëm.

Diagrami më poshtë e paraqet Strukturën e nivelit të lartë të sistemit, se si funksionalitetet dhe web faqet menaxhohen përmes SITK-ës.

Faqja fillestare quhet “FILLIMI (HOME)” dhe paraqet hyrjen e shkurtë në sistem dhe poashtu i mundëson shfrytëzuesve që t'i qasen funksionaliteteve tjera nga çdo modul. Shfrytëzuesit mund t'ju qasen moduleve individuale të aplikacionit të SITK-ës, të cilat janë paraqitur si katrorë të kaltër, përmes faqes për regjistrim (LOG-IN page) nga faqja fillestare.

Brenda moduleve ekzistojnë faqet të cilat përmbajnë funksionalitetet elementare të aplikacionit.



Në sistemin e kadastrit të modeluar për Kosovë, Blom&Orgut e ka zbatuar aplikacionin e bazuar në web duke përdorur teknologjitë ASP.NET, WCSF dhe kornizën CSLA .NET mbi bazën e të dhënave SQL Server 2005. Sistemi është centralizuar në nivelin shtetëror, kurse ZKK-ët janë të lidhura me aplikacion dhe serverin e bazës së të dhënave përmes web shfletuesit në rrjetin e siguruar Intranet.

Sistemi kadastral e modeluar dhe zhvilluar nga ekipi Blom&Orgut bazohet në qasjen e zgjidhjes së “kërkesës”, që donë të thotë se çdo ndryshim në bazën e të dhënave inicohet nga kërkesa e regjistruar nga klienti.

Nuk lejohet asnjë azhurnim i bazës së të dhënave pa kërkesë të vlefshme nga personi me të drejtë për t’u regjistruar në sistemin kadastral për t’i bërë ndryshimet që ndodhin në realitet: modifikimi i kufijve të pronës, nënndarja apo bashkimi i parcelave fqinje, regjistrimi i ndërtesave të reja, regjistrimi i ndryshimit të pronësisë apo hipotekës, etj.

Kërkesa e klientit (formulari standard për kërkesë) regjistrohet në sistem dhe i dërgohet apo caktohet shfrytëzuesit në sistem, roli i të cilit është përpunimi i kërkesave kadastrale apo atyre për regjistrim të të drejtave.

Kjo qasje ofron transparencë në regjistrimet kadastrale dhe e pengon korrupsionin dhe regjistrimin e rrejshëm të të dhënave.

Rregullat e verifikimit të vlefshmërisë të zbatuara në sistemin e kadastrit sigurojnë kualitet të mirë të të dhënave, shmangin mospërputhshmërinë e tyre, ruajnë integritetin e informatave kadastrale dhe ofrojnë strukturë të mirë të bazës së të dhënave.

Faqja ndërlidhëse në shumë gjuhë është një mjet tjetër i prezantuar nga sistemi kadastral i zhvilluar në SITK. Shtetet shumë kulturore si Kosova kanë nevojë për mbështetje në çështjen gjuhësore në të gjitha programet zyrtare kompjuterike në përdorim në administratën publike apo në Ministrinë e Administratës Publike.

SITK gjithashtu e ka zbatuar funksionin e nxjerrjes së arkivit dhe konsultimin e tij nga baza e të dhënave kadastrale: objektet e vjetra kadastrale arkivohen, e poashtu edhe pronarët e vjetër, të drejtat e vjetra etj. Gjurmimi i të dhënave arkivore është i mundur në çdo kohë duke i kërkuar numrat kadastral, numrin e regjistruar të kërkesës, emrin e pronarit, adresën, datën etj.

Të dhënat e ndryshme statistikore, raportet kadastrale, raportet e regjistrimit të të drejtave dhe regjistri janë modeluar dhe zbatuar në sistemin e SITK-ës. Raportet janë krijuar duke shfrytëzuar mjetin “Crystal Reports”, janë përshtatur për qëllimet e kadastrit dhe janë zbatuar me sukses me logo, formate dhe gjuhë speciale sipas traditave dhe zakoneve vendore.

Për t’i ndihmuar shfrytëzuesit në plotësimin e formularëve standard apo për t’ju shmangur shtypjes në përgjithësi dhe posaçërisht shtypjes së gabuar të të dhënave, të cilat përdoren shpesh, SITK-ja ofron zgjedhjen nga fjalorët e definuar më parë, siç janë:

NI i fjalorit	Kodi i sendit të fjalorit	Emri i sendit të fjalorit anglisht	Emri i sendit të fjalorit shqip	Emri i sendit të fjalorit serbisht
1	Country	Country	Shteti	Drzava
2	Streetype	StreetType	Lloji i rrugës	Vrsta ulice



NI i fjalorit	Kodi i sendit të fjalorit	Emri i sendit të fjalorit anglisht	Emri i sendit të fjalorit shqip	Emri i sendit të fjalorit serbisht
3	GenderType	GenderType	Lloji i gjinisë	Vrsta polova
4	IPRRCultureType	IPRRCultureType	Lloji i kulturës në RDPP	Vrsta kulture u RPNI-u
5	SupplyServicesType	SupplyServicesType	Lloji i shërbimit	Vrsta usluge
7	LandType	LandType	Lloji i tokës	Vrsta zemljista
9	QualityClass	QualityClass	Kualiteti i klasës	Kvalitet klase
11	CaseStatus	CaseStatus	Gjendja e lëndës	Stanje predmeta
12	IDType	IDType	Lloji i numrit identifikues	Vrsta broja za identifikaciju
13	Currency	Currency	Valuta	Valuta
14	CaseSettlingStageType	CaseSettlingStageType	Lloji i shkall. së zgji. së lëndës	Vrsta stupnja resenja predmeta
15	CaseType	CaseType	Lloji i lëndës	Vrsta predmeta
16	MethodOfApplying	MethodOfApplying	Metoda e aplikimit	Metoda podnosenja zahteva
17	CaseSettlingStageStatus	CaseSettlingStageStatus	Lloji i shkall. së zgji. së lëndës	Vrsta stupnja resenja predmeta
18	CommunicationType	CommunicationType	Lloji i komunikimit	Vrsta komunikacije
19	DocumentType	DocumentType	Lloji i dokumentit	Vrsta dokumenta
20	LegalCadOperationType	LegalCadOperationType	Lloji i aktivitetit kadastral juridik	Vrsta pravno katastarske aktivnosti
21	UtilityFormType	UtilityFormType	Lloji i përçojës	Vrsta provodnika
22	UtilityMaterialType	UtilityMaterialType	Lloji i materialit të përçojës	Vrsta materijala provodnika
23	RightType	RightType	Lloji i së drejtës	Vrsta prava
24	RightComponentType	RightComponentType	Lloji i komponentit të së drejtës	Vrsta sastavnog dela prava
25	Action	Action	Aktiviteti	Aktivnost
26	ServitudePurposeType	ServitudeDestinationType	Lloji i destinimit të servitutit	Vrsta namene sluzbenosti
27	UtilityType	UtilityType	Lloji i përçojës	Vrsta provodnika
28	ParcelTypeOfUse	ParcelTypeOfUse	Lloji i shfrytëzimit të parcelës	Vrsta koriscenja parcele
29	ParcelCurrentUse	ParcelCurrentUse	Shfrytëzimi aktual i parcelës	Trenutno koriscenje parcele
30	BuildingType	BuildingType	Lloji i ndërtesës	Vrsta zgrade
31	BuildingCurrentUse	BuildingCurrentUse	Shfrytëzimi aktual i ndërtesës	Trenutno koriscenje parcele

Për çdo fjalorë të tillë, AKK dhe ekipi Blom&Orgut i kanë përpunuar elementet e fjalorit: shënimet e mundshme standarde për çdo fjalor. Kur nga shfrytëzuesi kërkohet t'i plotësojë të dhënat kadastrale lidhur me parcelën, ai/ajo mund të zgjedhin nga lista “drop-down” (combo katrore apo lista) llojin e shfrytëzimit, shfrytëzimin aktual, klasën e kualitetit etj.

SubParcel Details

Insert

Culture Number	Parcel Type Of Use	Parcel Current Use	Quality Class	Area
Insert Cancel 1	Agriculture			

Agriculture
Forestry
Water
Construction land
OtherLand
PublicServices
Infrastructure

Hollësitë e nënparceles

Inserto

Numri i kultures	Lloji i shfrytëzimit te parceles	Shfrytëzimi aktual i parceles	Klasa e kualitetit	Sipërfaqja
Inserto Anulo 1	Bujqësore			

Bujqësore
Pyjor
Rajon Ujor
Tokë Ndërtimore
Tokë Tjetër
Shërbimet Publike
Infrastruktura

Sipas llojit të shfrytëzimit të parcelës që zgjidhet, lista e shfrytëzimit aktual të parcelës do të filtrohet dhe do t'i paraqesë vetëm ato parcela të cilat kanë të bëjnë me atë lloj të shfrytëzimit: p.sh. për bujqësi mund të zgjidhni arën, kopshtin etj. nga të gjitha shfrytëzimet aktuale që i përmban baza e të dhënave.

SubParcel Details

Insert

Culture Number	Parcel Type Of Use	Parcel Current Use	Quality Class	Area
Insert Cancel 1	Agriculture	Arable	1st Class Arable Lar	

Arable
Garden
meadow
pasture
orchard
Vineyard
Cane

Hollësitë e nënparceles

Inserto

Numri i kultures	Lloji i shfrytëzimit te parceles	Shfrytëzimi aktual i parceles	Klasa e kualitetit	Sipërfaqja
Inserto Anulo 1	Bujqësore	Arat	Arë E Klasës 1	

Arat
Kopshtet
Livadhi
Kullotat
Pemishtet
Vreshta
Kallam

Sipas shfrytëzimit aktual të parcelës të zgjedhur, lista e kualitetit të klasave do të filtrohet dhe do t'i paraqesë vetëm ato parcela të cilat kanë të bëjnë me atë lloj të shfrytëzimit: p.sh. për ara (tokë bujqësore) mund të zgjidhni klasën e parë bujq bujqësore, klasën e dytë etj. nga të gjitha klasat e kualitetit që i përmban baza e të dhënave.

SubParcel Details

Insert

Culture Number	Parcel Type Of Use	Parcel Current Use	Quality Class	Area
Insert Cancel 1	Agriculture	Arable	1st Class Arable Lar	

1st Class Arable Land
2nd Class Arable Land
3rd Class Arable Land
4th Class Arable Land
5th Class Arable Land
6th Class Arable Land
7th Class Arable Land
8th Class Arable Land



Hollësitë e nënparceles

Inserto

Numri i kultures	Lloji i shfrytëzimit te parceles	Shfrytëzimi aktual i parceles	Klasa e kualitetit	Siperfaqja
Inserto Anulo	1	Bujqësore	Arat	Arë E Klasës 1
			Arë E Klasës 1	200
			Arë E Klasës 2	
			Arë E Klasës 3	
			Arë E Klasës 4	
			Arë E Klasës 5	
			Arë E Klasës 6	
			Arë E Klasës 7	
			Arë E Klasës 8	

Të gjitha kompletet e elementeve (gjësendeve) të fjalorëve janë aprovuar nga kuadri i AKK-ës i cili ka marrë pjesë në fazën e analizimit dhe modelimit të bazës së të dhënave.

Më tepër hollësi lidhur fjalorët mund të gjeni në kaptinën e veçantë e cila i dedikohet kësaj çështjeje.

2. Pasqyra e përgjithshme e lëndëve

Për t'a përdorur web aplikacionin e SITK-ës në mënyrë adekuate, shfrytëzuesit duhet me e zgjidhë operacionin e caktuar kadastral apo juridik i cili paraqitet gjatë aktivitetit apo punës ditore të ZKK-ës.

Operacionet kadastrale kanë të bëjnë me krijimin e objekteve të reja kadastrale dhe/apo azhurnimin e objekteve ekzistuese kadastrale (me nënndarje, bashkim, regjistrim të parcelës së re, ndërtesës së re në parcelën ekzistuese apo banesën e re/ pjesën e ndërtesës).

Operacionet juridike kanë të bëjnë me regjistrimin e të drejtave mbi objektet kadastrale dhe/apo azhurnimin e të drejtave dhe komponentëve ekzistuese të të drejtave. Personat dhe objektet kadastrale janë në lidhmëni të fortë me të drejtat juridike të cekura dokumentet juridike. Regjistrimi i pronësisë, posedimit, hipotekës, servitutit janë shembuj të operacioneve juridike të cilat duhet me qenë në dispozicion në aplikacionin e SITK-ës dhe metoda adekuate e regjistrimit të të drejtave duhet të njihet hollësisht nga ana e shfrytëzuesve.

Për t'a kuptuar plotësisht se si funksionon SITK-ja, do të përdoren rastet e ndryshme për përpunimin e lëndëve bazuar në llojet dhe definicionet e tyre.

Llojet e lëndëve janë definuar me anë të procedurave kadastrale apo juridike me të cilat operohet gjatë përpunimit të lëndës.

Mënyra se si operohet në secilin lloj të lëndës do të shpjegohet në kaptinat në vijim.

Gjatë përpunimit të lëndës do të hasim në rregulla të përgjithshme të konfirmimit të vlefshmërisë të cilat do të aplikohen në aktivitetet e shfrytëzuesit, dhe për çdo lloj të lëndës do të ketë konfirmim special të vlefshmërisë nëse është e domosdoshme.

Shfrytëzuesi do të njoftohet nëse do të ketë vetëm tërheqje të vërejtjes, apo atij/asaj do t'i mohohet aktiviteti nëse ka gabime të cilat nuk mund të ruhen si informacione të mira në sistem apo ka gabime gjuhësore, gabime në shtypje etj.

Vërejtjet apo mesazhet për gabime do të paraqiten në ekran dhe shfrytëzuesi do të zgjedhë nëse do të vazhdojë apo do t'a korrigjojë informacionin dhe pastaj të vazhdojë.

Lista complete e llojeve të lëndëve është prezantuar në tabelën më poshtë. Për t'i ndihmuar shfrytëzuesit dhe për t'ju shmangur keqkuptimeve dhe konfuzioneve, është prezantuar lista e llojeve të lëndëve në të tri gjuhët në dispozicion në sistem.

Në anën e majtë të tabelës, me prapavijë të bardhë, është prezantuar **lloji “kryesor” i lëndëve** i cili ka të bëjë me operacionet kryesore kadastrale. Ai i grupon llojet e ngjashme të lëndëve dhe i përcakton rregullat e përgjithshme të konfirmimit të vlefshmërisë për operacionet kadastrale në fjalë.

Në anën e djathtë të tabelës, me prapavijë të gjelbër, ekzistojnë **llojet specifike të lëndëve** që korrespondojnë për çdo grup “kryesor” të llojeve të lëndëve.

Llojet e lëndëve janë prezantuar në të tri gjuhët për korrespondencë dhe krahasim dhe për t'ju shmangë keqkuptimeve apo konfuzioneve.



Për shembull, ekziston lloji “kryesor” i lëndëve për operacion kadastral i quajtur “Transferimi (bartja) e pronësisë” dhe lloji specifik i lëndës lidhur me metodën e transferimit të pronësisë:

Lloji KRYESOR i lëndës			Lloji SPECIFIK i lëndës		
anglisht	shqip	serbisht	anglisht	shqip	serbisht
Ownership Transfer	Bartja e pronësisë	Prenos vlasništva	Ownership Transfer by Seizure	Bartja e pronësisë Konfiskim	Prenos vlasništva Konfiskacija
			Ownership Transfer by Prescription	Bartja e pronësisë Mbajtje	Prenos vlasništva Održaj
			Ownership Transfer by Purchase	Bartja e pronësisë Blerja	Prenos vlasništva Kupovina
			Ownership Transfer by Expropriation	Bartja e pronësisë Eksproprijimi	Prenos vlasništva Eksproprijacija
			Ownership Transfer by Inheriting	Bartja e pronësisë Trashegimia	Prenos vlasništva Nasledstvo
			Ownership Transfer by Exchange	Bartja e pronësisë Kembimi	Prenos vlasništva Zamena
			Ownership Transfer by Gift	Bartja e pronësisë Dhurata	Prenos vlasništva Dar
			Ownership Transfer by Succession	Bartja e pronësisë Sukcesioni	Prenos vlasništva Sukcesija

Llojet e lëndëve të cilat shfrytëzuesi do t'i zgjedhë gjatë regjistrimit të lëndës janë llojet specifike të lëndëve me prapavijë të gjelbër.

Rregullat e përgjithshme të konfirmimit të vlefshmërisë për operacionet kadastrale në fjalë do të aplikohen në të gjitha ato që përmbahen në “nënlojet e lëndëve”, dhe konfirmimet specifike aplikohen në çdo lloj specifik të lëndëve kur kërkohet.

Lista e të gjitha konfirmimeve të vlefshmërisë, të përgjithshme dhe specifike, do të paraqitet me procedurat e përpunimit të lëndëve, së bashku me mesazhet për gabime dhe vërejtjet.



GRUPET E MËDHA të LLOJEVE të LËNDËVE (konfirmimi i përgjithshëm i vlefshmërisë aplikohet në të gjitha llojet e lëndëve të përmbajtura)				CASE TYPES (specific validations, other from general validations, are applied to each case type if necessary)				
ID e gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	ID E gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	Status of implementation in KCLIS
300	Subdivision	Nendarja	Cepanje	636	Subdivision	Nëndarja	Ceapnje	implemented with specific validations
301	Amalgamation	Bashkim	Spajanje	637	Amalgamation	Bashkimi	Spajanje	implemented with specific validations
302	Migration	Migrimi	Migracija	691	Migration from IPRR	Migrimi Prej RDPP-ës	Migracija Iz Rpnj-A	implemented with specific validations
303	Complex case group	Grup i Lëndë Komplekse	Grupa Slozen Predmet	692	Complex operations	Lëndë Komplekse (Sipas Detyrës Zyrtare)	Slozen Predmet (Po Sluzbenoj Duznosti)	implemented with specific validations
304	Ex-officio case group	Grup i lënda sipas detyrës zyrtare	Grupa Predmet po sluzbenoj duznosti	963	Ex-officio operations	Lënda sipas detyrës zyrtare	Predmet po sluzbenoj duznosti	implemented with specific validations
305	Dictionary Management group	Grup i Menaxhimi i fjalorit	Grupa Uprava recnikom	976	Dictionary Management	Menaxhimi i fjalorit	Uprava recnikom	only for database administrator
306	System initialisation	Caktimi i mjedisit të sistemit	Odredjivanje sredine sistema	977	System initialisation	Caktimi i mjedisit të sistemit	Odredjivanje sredine sistema	only for database administrator
1050	Ownership Establishment	Percaktimi i pronesise	Odredjivanje vlasnistva	1150	Ownership Establishment by Replacing Possession to ownership	Zevendesimi i posedimit te tokave shoqerore me pronesi	Zamena drzavine drustvenog zemljista sa vlasnistvom	
				1151	Ex-officio Ownership Establishment	Percaktimi i pronesise Sipas detyres zyrtare	Po sluzbenoj duznosti	implemented with specific validations
1051	Ownership Transfer	Bartja e pronesise	Prenos vlasnistva	1152	Ownership Transfer by Seizure	Bartja e pronesise Konfiskim	Prenos vlasnistva Konfiskacija	implemented with specific validations
				1153	Ownership Transfer by Prescription	Bartja e pronesise Mbajtje	Prenos vlasnistva Odrzaj	implemented with specific validations
				1154	Ownership Transfer by Purchase	Bartja e pronesise Blerja	Prenos vlasnistva Kupovina	implemented with specific validations
				1155	Ownership Transfer by Expropriation	Bartja e pronesise Eksprorijimi	Prenos vlasnistva Eksproprijacija	implemented with specific validations
				1156	Ownership Transfer by Inheriting	Bartja e pronesise Trashegimia	Prenos vlasnistva Nasledstvo	implemented with specific validations
				1157	Ownership Transfer by Exchange	Bartja e pronesise Kembimi	Prenos vlasnistva Zamena	implemented with specific validations
				1158	Ownership Transfer by Gift	Bartja e pronesise Dhurata	Prenos vlasnistva Dar	implemented with specific validations
				1159	Ownership Transfer by Succession	Bartja e pronesise Sukcesioni	Prenos vlasnistva Sukcesija	implemented with specific validations
1052	Ownership Modification	Modifikimi i pronesise	Modifikacija vlasnistva	1160	Ownership Update of Description	Modifikimi i pronesise Ndryshimi i pershkrimit	Modifikacija vlasnistva Promena opisa	implemented with specific validations
1053	Possession Establishment	Percaktimi i posedimit të pronës shoqerore	Odredjivanje drzavine drustvene imovine	1161	Ex-officio establishment of possession	Krijimi i posedimit te prones shoqerore sipas detyres zyrtare	Stvaranje drzavine na drustvenoj imovini po sluzbenoj duznosti	
1054	Possession Transfer	Bartja e posedimit te pronës shoqërore	Prenos drzavine drustvene imovine	1162	Possession Transfer by Succession	Bartja e posedimit te pronës shoqërore Sukcesion	Prenos drzavine drustvene imovine Sukcesija	implemented with specific validations
				1163	Possession Transfer by Seizure	Bartja e posedimit te pronës shoqërore Konfiskim	Prenos drzavine drustvene imovine Konfiskacija	implemented with specific validations
				1164	Possession Transfer by Expropriation	Bartja e posedimit te pronës shoqërore Eksprorijimi	Prenos drzavine drustvene imovine Eksproprijacija	implemented with specific validations
				1165	Possession Transfer by Inheriting	Bartja e posedimit te pronës shoqërore Trashegimi	Prenos drzavine drustvene imovine Nasledstvo	implemented with specific validations
				1166	Possession Transfer by Gift	Bartja e posedimit te pronës shoqërore Dhurata	Prenos drzavine drustvene imovine Dar	implemented with specific validations



GRUPET E MËDHA të LLOJEVE të LËNDËVE (konfirmimi i përgjithshëm i vlefshmërisë aplikohet në të gjitha llojet e lëndëve të përmbajtura)				CASE TYPES (specific validations, other from general validations, are applied to each case type if necessary)				
ID e gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	ID E gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	Status of implementation in KCLIS
				1167	Possession Transfer by Exchange	Bartja e posedimit të pronës shoqërore Kembim	Prenos drzavine drustvene imovine Razmena	implemented with specific validations
				1168	Possession Transfer by Purchase	Bartja e posedimit të pronës shoqërore Blerje	Prenos drzavine drustvene imovine Kupovina	implemented with specific validations
				1169	Possession Transfer Prescription	Bartja e posedimit të pronës shoqërore Mbatje	Prenos drzavine drustvene imovine Odrzavanje	implemented with specific validations
1055	Possession Modification	Modifikimi i posedimit të pronës shoqërore	Modifikacija drzavine drustevnog vlasnistva	1170	Possession Update of Description	Modifikimi i posedimit të pronës shoqërore Ndryshimi i pershkrim	Modifikacija drzavine drustevnog vlasnistva Promena opisa	implemented with specific validations
1087	Tax Lien Establishment	Percaktimi i barres ne prone per shkak te mospagimit te tatimit	Odredjivanje pridrza na imovini zbog neplacanja poreza	1220	Tax Lien Establishment by Tax Authority	Percaktimi te tatimit mbi ponën Sipas administrates tatimore	Odredjivanje Porez na imovinu Prema poreznoj upravi	
1088	Tax Lien Modification	Modifikimi i barres ne prone per shkak te mospagimit te tatimit	Modifikacija pridrza na imovini zbog neplacanja poreza	1221	Tax Lien Update Description or terms	Modifikimi te tatimit mbi ponën i pershkrim apo afatit kohore	Modifikacija Porez na imovinu Modifikacija opisa ili roka	
1089	Tax Lien Cancellation	Anulimi i barres ne prone per shkak te mospagimit te tatimit	Ponistenje pridrza na imovini zbog neplacanja poreza	1222	Tax Lien Cancellation by Tax Authority decision	Anulimi te tatimit mbi ponën Sipas vendimit te administrates tatimore	Ponistenje Porez na imovinu Po resenju poreznoj upravi	
				1223	Tax Lien Cancellation due to Court Decision	Anulimi te tatimit mbi ponën Sipas vendimit te gjykates	Ponistenje Porez na imovinu Po sudskom resenju	
1094	Mortgage Establishment	Percaktimi i hipotekes	Odredjivanje hipoteke	1240	Mortgage Establishment by Contract	Percaktimi i hipotekes Kontrata e hipotekes	Odredjivanje hipoteke Ugovor o hipoteci	implemented with specific validations
1095	Mortgage Transfer	Bartja e hipotekes	Prenos hipoteke	1241	Mortgage Transfer Selling dept	Bartja e hipotekes Shtija e borxhit	Prenos hipoteke Prodaja duga	
				1242	Mortgage Transfer by Succession	Bartja e hipotekes Sukcesioni	Prenos hipoteke Sukcesija	
1096	Mortgage Modification	Modifikimi i hipotekes	Modifikacija hipoteke	1243	Mortgage Update of description or terms	Modifikimi i hipotekes Ndryshimi i pershkrim apo afatit kohore	Modifikacija hipoteke Promena opisa ili roka	
1097	Mortgage Cancellation	Anulimi i hipotekes	Ponistenje hipoteke	1244	Mortgage Cancellation by the end of the term	Anulimi i hipotekes Sipas skadimit te afatit	Ponistenje hipoteke Po isteku roka	
				1245	Mortgage Cancellation by the Declaration of the empowered Party	Anulimi i hipotekes Me deklarate te pales se autorizuar	Ponistenje hipoteke Uz izjavu ovlasene strane	
				1246	Mortgage Cancellation by Court Decision	Anulimi i hipotekes Sipas vendimit te gjykates	Ponistenje hipoteke Po sudskom resenju	
1098	Caveat Establishment	Percaktimi i verejtjes	Odredjivanje napomene	1247	Caveat Establishment by Court Decision	Percaktimi i verejtjes Sipas vendimit te gjykates	Odredjivanje napomene Po sudskom resenju	implemented with specific validations
				1248	Caveat Establishment by applicant request	Percaktimi i verejtjes Sipas kerkeses se pales	Odredjivanje napomene Prema zahtevu stranke	
				1254	Caveat Establishment by Contract	Percaktimi i verejtjes Sipas kontrates	Odredjivanje napomene Po ugovoru	
1099	Caveat Transfer	Bartja e verejtjes	Prenos napomene	1249	Caveat Transfer by inheriting	Bartja e verejtjes Sipas trashegimise	Prenos napomene Po nasledstvu	
1100	Caveat Modification	Modifikimi i verejtjes	Modifikacija napomene	1250	Caveat Update by changing description or terms	Modifikimi i verejtjes Sipas ndryshimit të përshkrimit te afatit	Modifikacija napomene Prema promeni opisa roka	
1101	Caveat Cancellation	Anulimi i verejtjes	Ponistenje napomene	1251	Caveat Cancellation by the end of the term	Anulimi i verejtjes Sipas skadimit te afatit	Ponistenje napomene Po isteku roka	
				1252	Caveat Cancellation by the applicant request	Anulimi i verejtjes Sipas kerkeses se pales	Ponistenje napomene Prema zahtevu stranke	



GRUPET E MËDHA të LLOJEVE të LËNDËVE (konfirmimi i përgjithshëm i vlefshmërisë aplikohet në të gjitha llojet e lëndëve të përmbajtura)				CASE TYPES (specific validations, other from general validations, are applied to each case type if necessary)				
ID e gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	ID E gjësëndit të fjalorit	ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	Status of implementation in KCLIS
				1253	Caveat Cancellation by a Court Decision	Anulimi i vërejtjes Sipas vendimit të gjykates	Ponistenje napomene Po sudskom resenju	
1105	Parcels Establishment	Percaktimi (krijimi) i parcelave	Odredjivanje (stvaranje) parcela	1259	Parcels Establishment registering a new parcel by surveying measurements	Percaktimi (krijimi) i parcelave Regjistrimi i parceles se re sipas matjeve gjeodezike	Odredjivanje (stvaranje) parcela Uknjizenje nove parcele prema geodestkim premerima	implemented with specific validations
1106	Parcels Transforming	Transformimi i parcelave	Transformacija parcela	1261	Parcels Transforming Ex-officio corrections	Transformimi i parcelave Korrigimet sipas detyres zyrtare	Transformacija parcela Ispravke po službenoj dužnosti	implemented with import from CSV file
1107	Parcels Modification	Modifikimi i parcelave	Modifikacija parcela	1277	Parcels Update by changing address	Modifikimi i parcelave Me ndryshimin e adreses	Modifikacija parcela Izmenom adrese	
1130	Cadastral Zone Transforming	Transformimi i zones kadastrale	Transformacija katastarske zone	1376	Cadastral Zone Transforming by replacing existing data with reconstructed data	Transformimi i zones kadastrale Duke i zevendesuar te dhenat ekzistuese me ato te rindërtuara	Transformacija katastarske zone Uz zamenu postjernih podataka sa onim iz rekonstrukcije	implemented with import from CSV file
1133	Persons Data Modification	Modifikimi i te dhenave per persona	Modifikacija podataka o licima	1344	Persons' Data Update	Modifikimi i te dhenave per persona	Modifikacija podataka o licima	
1134	Data Service	Sherbimi i te dhenave	Sluzba za podatke	1345	Data Service - Issue certificate	Sherbimi i te dhenave - Ofruar certifikate	Sluzba za podatke - Davanjem izvoda	implemented with printing report
				1370	Data Service of Municipality providing data to Tax Authority	Sherbimi i te dhenave per komune Ofrimi i te dhenave administrates tatimore	Sluzba za podatke za opstinu Obezbedjenje podataka upravi za porez	extracts data in CSV file
				1371	Data Service of Municipality providing data to other Kosovo Authority	Sherbimi i te dhenave per komune Ofrimi i te dhenave organeve tjera te Kosoves	Sluzba za podatke za opstinu Obezbedjenje podataka ostalim organima Kosova	extracts data in CSV file
				1372	Data Service of Cadastral Zone providing data to Tax Authority	Sherbimi i te dhenave per zonat kadastrale Ofrimi i te dhenave administrates tatimore	Sluzba za podatke za katastarske zone Obezbedjenje podataka upravi za porez	extracts data in CSV file
				1373	Data Service of Cadastral Zone providing data to other Kosovo Authority	Sherbimi i te dhenave per zonat kadastrale Ofrimi i te dhenave organeve tjera te Kosoves	Sluzba za podatke za katastarske zone Obezbedjenje podataka ostalim organima Kosova	extracts data in CSV file
				1374	Data Service of Cadastral Zone providing data to surveyors for Cadastral Reconstruction	Sherbimi i te dhenave Ofrimi i te dhenave gjeodeteve privat per rindërtimin e kadastrit	Sluzba za podatke Obezbedjenje podataka privatnim geodetama za kadastrsku rekonstrukciju	extracts data in CSV file
				1375	Data Service of data by providing data to private surveyors (selected cadastral Objects regarding given CZ)	Sherbimi i te dhenave per objectit kadastral sipas ofrimit te te dhenave gjeodeteve privat	Usluge podataka za katastarske objektet Prema davanju na raspolaganje podataka privatnim geodetama	extracts data in CSV file

3. Skenarët e bazuar në llojet e ndryshme të lëndëve

Skenarët do t'i ofrojnë ndihmë shfrytëzuesve gjatë operimit me aplikacionin e SITK-ës sepse ato bazohen në llojet e ndryshme të lëndëve dhe kanë për qëllim të kalojnë nëpër të gjitha hapat në dispozicion në aplikacionin e programit kompjuterik dhe t'i kontrollojnë ato, për t'a përpunuar lëndën me sukses.

Shfrytëzuesit e SITK-ës duhet t'i zbatojnë hapat e ardhshëm për t'a përpunuar lëndën e caktuar të llojit të caktuar. Ata ndihmohen mjaft me shpjegimet dhe tabelat (figurat) e aplikacionit.

Skenarët do t'i përfshijnë **të gjitha hapat dhe procedurat** e nevojshme për përpunimin e lëndës, duke filluar nga regjistrimi i lëndës në SITK, caktimi i lëndës për shfrytëzuesit për përpunim dhe verifikim, procedurat e zgjidhjes së lëndës, verifikimi i vlefshmërisë i lëndës së përpunuar dhe procesi i verifikimit, i cili mund të ketë si rezultat pranimin apo refuzimin e lëndës në përpunim.

Skenarët do të fillojnë me regjistrimin e lëndës, varësisht nga lloji i lëndës për të cilën pala ka parashtruar kërkesë, dhe kjo është arsyeja pse ne do të paraqesim se si regjistrohet lënda (çfarëdo lloji i lëndës) në fillim në kaptinë të veçantë, dhe pastaj, gjatë përshkrimit se si përpunohen llojet e ndryshme të lëndëve, do të thirremi në hollësitë relevante të kësaj kaptine.

Të njëjtën do t'a bëjmë lidhur me caktimin e lëndës për shfrytëzuesit të cilët do t'a përpunojnë dhe verifikojnë lëndën. Procedura e caktimit të lëndës do të shpjegohet hollësisht në kaptinë të posaçme të, dhe pastaj, gjatë përshkrimit se si përpunohen llojet e ndryshme të lëndëve, do të thirremi në hollësitë relevante të kësaj kaptine.

Regjistrimi i lëndës duke i plotësuar saktësisht të gjitha të dhënat në faqen "**Regjistro lëndën**" dhe faqen "**Regjistro personin**" është shumë i rëndësishëm për faktin se ky informacion do të shfrytëzohet në hapat e përpunimit të lëndës dhe në lëndët e ardhshme nëse pala/personi i njëjtë kërkon shërbime tjera nga ZKK apo AKK.

Duke i futur të dhënat e sakta dhe të plota për palën (klientin) që parashtron kërkesë në ZKK, baza e të dhënave e SITK-ës do të ketë të dhëna të sakta dhe në vazhdimësi do të begatohet me të dhëna për persona, dhe herën e ardhshme kur i njëjti person parashtron kërkesë të re në ZKK, këto të dhëna mund të shfrytëzohen në të ardhmen dhe do t'i kursejnë shfrytëzuesit të SITK-ës mjaft kohë dhe përpjekje në ofrimin e shërbimeve këtij personi (pale), sepse do t'i mundësojë shfrytëzuesit t'a regjistrojë dhe përpunojë lëndën më shpejtë dhe më lehtë.

Pasi të regjistrohet lënda, të gjitha fushat e obligueshme (fushat e kërkuara) plotësohen dhe kontrollohen nga ana e aplikacionit, hapi tjetër do të jetë **Caktimi i lëndës**: lëndët i caktohen referentit për procedurën e zgjidhjes së lëndës dhe poashtu i caktohet verifikuesve për procedurën verifikuese.

Pas caktimit të lëndës, çdo shfrytëzues do t'a gjen listën e lëndëve të cilat i janë caktuar atij/asaj për t'i përpunuar dhe zgjidhur, lista e cila është paraqitur në faqen "**Lista për zgjidhjen e lëndëve**" i paraqet lëndët sipas datë, për t'a gjetur së pari lëndën më të vjetër e cila duhet të trajtohet.

Tabela e listës së lëndëve të cilat duhet të përpunohen nga ana e shfrytëzuesit e ka një kolonë për çdo lëndë ku ekziston pulla e quajtur [Përpunimi nga departamenti i kadastrit](#), e cila paraqitet në ekran si link. Duke e shtypur këtë pullë, [Përpunimi nga departamenti i kadastrit](#), lënda e zgjidhur për përpunim, shfrytëzuesi udhëzohet të kalojë në faqen tjetër e cila quhet "**Zgjidhje e lëndës**" e cila i përmban të gjitha informatat e nevojshme për përpunimin e lëndës.

Kjo faqe paraqitet si "tabela e komandave": hollësitë e lëndës së zgjedhur në maje si titull dhe dy tabela në anën e majtë dhe të djathtë – Tabela e gjendjes së vjetër dhe Tabela e gjendjes së re.

Koncepti i kësaj faqeje përmbahet në paraqitjen në ekran të gjendjes së vjetër para se të përpunohet lënda dhe të krijohet gjendja e re nga shfrytëzuesi, me qëllim që të përpunohet ajo që është kërkuar në kërkesën palës.

Në TABELËN E GJENDJES SË VJETËR, shfrytëzuesi do t'a zgjedhë një objekt kadastral ekzistues apo disa objekte kadastrale nga baza e të dhënave, për të qenë i azhurnuar apo modifikuar në TABELËN E GJENDJES SË RE, ashtu si edhe lloji i lëndës kërkon.

Shfrytëzuesi është në gjendje t'i konsultojë të gjitha informatat lidhur me hollësitë kadastrale apo të drejtat e objektit kadastral të zgjedhur në TABELËN E GJENDJES SË VJETËR. Për t'i pa me sy të drejtat e objektit kadastral të zgjedhur, shfrytëzuesi duhet me kliku në pullën "[Tregoi të drejtat](#)", dhe të drejtat do të paraqiten në listën nën Objektin kadastral.

Nëse lloji i lëndës nënkupton azhurnimin apo modifikimin e të dhënave e objektit të zgjedhur kadastral nga TABELA E GJENDJES SË VJETËR, shfrytëzuesi do të duhet me i zgjedhë ato objekte në TABELËN E GJENDJES SË RE dhe t'i bën modifikimet aty.

Të gjitha të dhënat e paraqitura në ekran në TABELËN E GJENDJES SË VJETËR janë vetë për lexim dhe janë vetëm për shikim.

Të gjitha të dhënat e paraqitura në TABELËN E GJENDJES SË RE përkohësisht ruhen dhe mund të editohen derisa lënda të dërgohet për verifikim. Të dhënave kadastrale të përmbajtura në TABELËN E GJENDJES SË RE i konfirmohet vlefshmëria dhe kontrollohen automatikisht nga ana e aplikacionit, duke aplikuar një sërë rregullash për konfirmim të definuar gjatë analizimit të sistemit.

Nëse lloji i lëndës nënkupton nëndarjen apo bashkimin e objektit kadastral të zgjedhur nga TABELA E GJENDJES SË VJETËR, shfrytëzuesi do të duhet me e krijuar Objektin e ri kadastral në TABELËN E GJENDJES SË RE dhe duhet t'i plotësojë të gjitha hollësitë kadastrale dhe të drejtat e parcelave të reja duke përdorur pullën "[Krijo objekt të ri kadastral](#)" për këtë operacion dhe pastaj pullën "[Inserto të drejtat](#)" apo "[Kopjo të drejtat](#)" për t'i kompletuar informatat kadastrale në parcelat e reja.

Nëse lloji i lëndës nënkupton krijimin e një objekti kadastral krejtësisht të ri, TABELA E GJENDJES SË VJETËR do të jetë e zbrazët dhe shfrytëzuesi do të duhet me krijuar Objekt të ri kadastral në TABELËN E GJENDJES SË RE dhe duhet t'i plotësojë të gjitha hollësitë kadastrale dhe të drejtat e parcelave të reja duke përdorur pullën "[Krijo objekt të ri kadastral](#)" për këtë operacion dhe pastaj pullën "[Inserto të drejtat](#)" për t'i kompletuar informatat kadastrale në parcelat e reja.

Shfrytëzuesi i cili e përpunon/zgjidhë lëndën ka mundësinë me e pa "**Përmbledhjen e lëndës**", një faqe tjetër ku do të paraqitet Gjendja e vjetër e çdo Objekti kadastral dhe Gjendjen e re me të gjitha ndryshimet e objektit kadastral, varësisht nga lloji i lëndës.

Pasi të përfundohen të gjitha procedurat për përpunimin e lëndës, lëndëve duhet t'i konfirmohet vlefshmëria "[Konfirmo vlefshmërinë e lëndës](#)" dhe duhet të dërgohen për verifikim në "[Dërgo për verifikim](#)".

Shfrytëzuesi i caktuar për verifikimin e lëndës do t'a gjen lëndën e cila pret për verifikim në faqen "**Lista për verifikimin e lëndëve**". Shfrytëzuesi për verifikim do t'a zgjedhë lëndën për verifikim dhe pastaj do të hapet faqja "**Verifikimi i lëndëve**".

Faqja "**Verifikimi i lëndëve**" është e ngjashme me faqen "**Zgjidhja e lëndëve**", e cila i prezanton të dhënat kadastrale në TABELËN E GJENDJES SË VJETËR dhe në TABELËN E GJENDJES SË RE, pasi lënda të jetë përpunuar nga ana e referentit kadastral. Referenti për verifikim mundet vetëm me pa se çka është punuar dhe mund të vendosë nëse lënda mund të pranohet apo nëse ajo duhet të refuzohet, apo nëse të dhënat mund të korrigjohen dhe se lënda do të duhet me u kthyer prapa te shfrytëzuesi për korrigjim.



Pas analizimit të asaj që është kryer në lëndë, dhe nëse të dhënat kadastrale janë të sakta dhe pa gabime, lënda do të **Pranohet**, në të kundërtën lënda do të **Refuzohet** apo **Dërgohet prapa për korrigjim**.

Pasi lënda të **Pranohet**, ajo do të mbyllet dhe të dhënat kadastrale që janë modifikuar gjatë përpunimit të lëndës, do të ruhen përgjithmonë në bazën e të dhënave të SITK-ës dhe do të shfrytëzohen për referencat e ardhshme apo do të paraqiten në ekran në përpunimet e ardhshme të lëndëve tjera.

Pasi lënda të **Refuzohet**, ajo do të mbyllet dhe të dhënat kadastrale që janë modifikuar gjatë përpunimit të lëndës do të fshihen nga baza e të dhënave e SITK-ës, të gjitha modifikimet e të dhënave kadastrale do të anulohen, Objektet kadastrale do të kthehen në gjendjen e mëparshme (fillestare), dhe Objekti i ri kadastral, i krijuar gjatë përpunimit të lëndës së refuzuar, do të fshihet nga baza e të dhënave.

Pas pranimit apo refuzimit të lëndës, shfrytëzuesi verifikues do të jetë në gjendje me e paraqitë në ekran dhe me e shtypë formularin e njoftimit i cili do t'i jepet palës, si rezultat i kërkesës për përpunim në aplikacionin e SITK-ës.

Në faqet në vijim janë paraqitur hapat e përpunimit të llojit të lëndës të cilat pritet që së shpeshti do të përdoren në aktivitetet e përditshme të ZKK-ve.

Lista e skenarëve do të zgjerohet me avancimin e zhvillimit të SITK-ës.




MODULI PËR MENAXHIMIN E LËNDËS


1. Si me u Kyçë (Log-in) në SITK

Për t'ju qasur funksionaliteteve të SITK-ës, shfrytëzuesit duhet të kyçen (log-in) në sistem. Sipas të drejtave për qasje të shfrytëzuesve të cilat janë të parapara t'i jepen çdo shfrytëzuesi nga ana e administratorit të sistemit, funksionalitetet e SITK-ës kanë me qenë apo nuk kanë me qenë në dispozicion për shfrytëzuesit e regjistruar (logged-in).

Nga faqja kryesore e quajtur FILLIMI (“HOME”), shfrytëzuesi duhet të klikojë në pullën “Kyçu” (“Login”) në anën e djathtë të epërme të faqes.



Faqja e re do të hapet, ku shfrytëzuesi mundet me e futë “emrin e shfrytëzuesit” dhe “fjalëkalimin” i cili jepet nga sistemi i SITK-ës.



Në rast se futet apo shtypet gabimisht “emri i shfrytëzuesit” dhe “fjalëkalimi”, do të paraqitet mesazhi për gabim për t’a njoftuar shfrytëzuesin se duhet me e rishtypur “emrin e shfrytëzuesit” dhe “fjalëkalimin”. Që të dy katrorët janë “case-sensitive” që donë të thotë se shkronjat më lartë dhe më poshtë ndryshojnë kur shtypen, dhe sistemi i interpreton ato të poshtmet dhe të lartat si të ndryshme.

Login

Log In

User Name:

Password:

☐ Remember me next time.

Your login attempt was not successful. Please try again.

Kyçu

Kyçu

Emri i shfrytëzuesit:

Fjalëkalimi:

☐ Me mbaje ne mend heren e ardhshme

Tentimi i juaj për tu regjistruar nuk ka qenë i suksesshem. Lutemi të provoni prap!

Në rastin e joaktivitetit të gjatë të shfrytëzuesit në sistem, aplikacioni i SITK-ës e shkyç shfrytëzuesin automatikisht, dhe me këtë rast paraqitet mesazhi i vërejtjes:

Login

Session Expired! Please Log In!

Log In

User Name:

Password:

☐ Remember me next time.

Kyçu

Koha ka skaduar. Luteni të kyçeni përsëri!

Kyçu

Emri i shfrytëzuesit:

Fjalëkalimi:

☐ Me mbaje ne mend heren e ardhshme



2. Si me i regjistruar lëndët

Të gjitha operacionet lejohen të kryhen në SITK përmes një “kërkese” zyrtare të parashtruar nga ana e palëve (klientëve): pronarëve, poseduesve, personave të autorizuar apo nga palët e interesuara, e cila kërkesë parashtrohet në ZKK-ët.

“**Kërkesa**” i parashtrohet ZKK-ës nga pala e interesuar apo klienti një formularë zyrtar të kërkesës e cila është në dispozicion në formë të letrës:

 Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government									
MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY									
Form no.1.									
IMMOVEABLE PROPERTY REGISTER APPLICATION FORM									
Municipality					Cadastral Zone				
1. Data for request applicant					Protocol No.				
Surname:			Name (Company name):			Parent name:			
Personal number:			Business Registration No (Legal persons and Companies only)						
Address:	Place		Municipality						
	Street		House No	Entrance No	Apartment No	Floor	Phone No		
2. Data on the previous owner:									
Surname:			Name (Company name):			Parent name:			
Personal number:			Business Registration No (Legal persons and Companies only)						
Address:	Place		Municipality						
	Street		House No	Entrance No	Apartment No	Floor	Phone No		
3. Data on the applicant as a representative: ☐ legal ☐ by proxy									
Surname:			Name (Company name):			Parent name:			
Personal number:			Business Registration No (Legal persons and Companies only)						
Address:	Place		Municipality						
	Street		House No	Entrance No	Apartment No	Floor	Phone No		
4. Hereby I request from the Municipal Cadastre Office to enter into Immoveable Property Register the following:									
1 ☐ Ownership transfer 2 ☐ Registration of ownership: a) ☐ parcel b) ☐ apartment c) ☐ building 3 ☐ Sub-division of: a) ☐ parcel b) ☐ apartment c) ☐ house 4 ☐ Merge of: a) ☐ parcel b) ☐ apartment 5 ☐ Correction of Immoveable Property Register 6 ☐ Registration of property with Mortgage – Attach Appendix for Mortgage					7 ☐ Registration of property with Servitude – Attach Appendix for Servitude 8 ☐ Registration of Easement 9 ☐ Right of use 10 ☐ Registration of Property Tax 11 ☐ Leasehold according to regulation 2003/13// 12 ☐ Other service				
